

VENDIM
Nr.340, datë 13.5.1996

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË
30.5.1994 “PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHETITIT NGA
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 në fund të pikës 1, shtohet:

“Të gjitha mallrat që sipas kritereve të përcaktuara me ligj, kanë plotësuar kohën e qëndrimit në organet doganore dhe kalojnë në pronësi të shtetit, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit.”.

Në fund të pikës 5 shtohet:

“Për mallrat, që në vazhdimësi do të kalojnë në pronësi të shtetit, organet administrative njoftojnë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe degët e saj në rrethin ku vepron organi administrativ.

Këto mallra merren në administrim nga organet e rezervës shtetërore, brenda 20 ditëve nga çasti i njoftimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi